



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 12/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Shërbimet e veçanta kontraktuale për përfaqësinë ligjore për nevojat e Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 06.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e veçanta kontraktuale për përfaqësinë ligjore për nevojat e Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Shërbimet e veçanta kontraktuale për përfaqësinë ligjore për nevojat e Komunës së Prishtinës” me nr. të prok: 616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 06.01.2020 me nr. 12/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Shërbimet e veçanta kontraktuale për përfaqësinë ligjore për nevojat e Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-19-8564-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit dhe nenit 30.1 të dosjes së tenderit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.01.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt:28.01.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Pretendimi i parë i OE ankues është se sipas nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, autoriteti kontraktues ka parapatë si kriter që OE duhet të këtë staf profesional, të paktën 3 jurist me provim të jurisprudencës, ku është cekur që të dëshmohet që juristët të kenë diplomë- certifikatën e jurisprudencës (e nuk është kërkuar licenca). Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit më ka eliminuar si OE që nuk kam dorëzuar licencën e dy avokatëve (kriter që nuk është kërkuar në dosje të tenderit) edhe pse unë në dosjen e tenderit për stafin tim profesional kam dëshmuar me 3 (tre) jurist me diplomë dhe certifikatë të jurisprudencës ashtu siç është kërkuar. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë dhe ne kërkesat e AK sqaron kërkesë e AK-së ne DT tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qenë:

Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. 1. ne baze të Ligjit për Avokatinë, neni 2 Zyra e Avokatit Avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë në zyrën individuale, në zyrën e përbashkët të avokatëve ose në shoqërinë të avokatëve, të regjistruar në regjistrin e Odës. OE duhet të ofroj dëshmi se është i regjistruar në regjistrin e Odës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopje të regjistrimit të biznesit së bashku me veprimtaritë e regjistrimit.
2. Certifikatën përkatëse.

9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe Professional: 1. Stafi Profesional Te paktën 3 jurist me provim të jurisprudencës	Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Diploma certifikata e jurisprudencës
-----------	---	--

Gjithashtu eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit të ofertës së OE ankues konstaton se në ofertën në fjalë tek stafi profesional ka të bashkangjitur certifikatat e dy juristëve të cilat dëshmojnë se personat në fjalë kanë përfunduar provimin e jurisprudencës po ashtu edhe z. Fatmir Gashi ka vërtetim të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike Departamenti i Administratës gjyqësore ku thuhet se ka dhënë provimin e Judikaturës me dt.25.06.2006.

Me dt.25.11.2019 AK-ës ka ngarkuar në sistemin e e-prokurimit përgjigjeje ndaj kërkesës për informacion shtesë të OE ku në pyetjen e parë thuhet. Citoj: A është e nevojshme që OE të jenë të licencuar nga Oda e Avokateve, apo mjafton të jenë të regjistruar si biznes dhe që ushtrojnë veprimtari juridike. Përgjigja nga ana e AK-së citoj: Në bazë të Ligjit për Avokatinë, është obligim ligjor që të jenë të regjistruar edhe në Oden e Avokateve.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në nenin 2 të Ligji Nr. 04/L-193 Për Avokatinë ku thotë: Avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë në zyrën individuale, në zyrën e përbashkët të avokatëve ose në shoqërinë të avokatëve, të regjistruar në regjistrin e Odës.

Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues është dashur të këtë parasysh LIGJI Nr. 04/L-193 Për Avokatinë ku sqarohet qartë se duhet të jenë të regjistruar në Oden e Avokateve për të ushtruar avokatinë, ku nga ky institucion duhet të pajiseni me licencë për të punuar si avokat. OE ankues nuk ka të bashkangjitur në ofertën e tij Licencat nga Oda e Avokateve të Kosovës për stafin tjetër, ku dihet se këta avokat duhet ta

përfaqësojnë komunën në rast se shpallet fitues OE me te cilin kanë lidhur kontratë pune. Prandaj bazuar ne sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Pretendimi tjetër i OE ankues është sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar Autoriteti Kontraktues me ka eliminuar me pretendimet që çmimi i ofertuar nga OE Ardita Morina tejkalon çmimin e tregut i cili është i përcaktuar në bazë të rregullores për tarifat avokatëve të datës 18.03.2017. Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 30.1 të dosjes së tenderit më ka eliminuar me pretendimet se çmimi i ofertuar nga OE tejkalon çmimin e tregut në bazë të rregullores së tarifave të Odës së avokatëve, gjë që në dosjen e tenderit kriter për dhënien e tenderit kanë qenë që OE të jetë i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, e nuk ka qenë kriter që çmimet të jenë sipas rregullores së tarifave të Odës së Avokatëve. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne ligjin për Tarifat e Avokateve Neni 4. 1. Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj tarife, Avokati dhe Klienti ose personi i autorizuar mundë të kontraktojnë shpërblimin për shërbimet e Avokatit dhe shpenzimet shoqëruese me marrëveshje të lirë ndërmjet tyre. Gjithashtu nuk ka qene kërkesë e AK që te respektohen tarifat e avokateve. Prandaj bazuar ne nenin e lart përmendur del se Avokati mund te bëj marrëveshje të lirë për çmim. Andaj nga sqarimet që u dhanë me lart del se kjo arsyeje e eliminimit nuk qëndron.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK nuk e ka specifikuar në dosjen e tenderit se çmimet duhet të jenë sipas rregullores së Avokatëve të Kosovës dhe nuk e ka specifikuar se sa palë janë përfshirë në një kontest civil. Të njëjtën gjë nuk e ka sqaruar edhe pas parashtrimit të pyetjeve nga OE për sqarimin e tenderit se sa është numri orientues i porosive që do të bëhet nga AK dhe si do të përcaktohen çmimet për porosi të njëjtit. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne pyetjen e kërkesës për sqarim shtesë nga ana e OE sqaron se pyetja ishte citoj: sa është nr. orientues i porosive që do të bëhen nga AK. Përgjigjja nga ana e AK-së citoj: Numri I porosive nuk mund te përcaktohet sepse nuk është e mundshme ta dimë se sa paditës potencial mund te kemi, ose sa seanca do te mbahen. Gjithashtu eksperti shqyrtues sqaron se qëndron fakti se AK nuk mund të dijë se sa paditës potencial mund te këtë, ose sa seanca do te mbahen. Prandaj bazuar ne sqarimet me lartë del se ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues është sipas raportit të vlerësimit dt; 17.12.2019, të tenderit me numër të prokurimit 616-19 -8564-2-2-1, shërbimet e veçanta kontraktuale për përfaqësinë ligjore për nevojat e Komunës së Prishtinës, tek lista e plotë standarde për përshtatshmërinë administrative të tenderit, OE Ardita Morina shihet që i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara (ndërsa OE të tjerë nuk i kanë plotësuar) dhe se komisioni për vlerësimin ka identifikuar tenderuesin, OE Ardita M. Morina si të suksesshme dhe ka rekomanduar për dhënien e kontratës (provë të bashkangjitur e keni raportin e vlerësimit të dt.17.12.2019).

Autoriteti Kontraktues duke qenë në kundërshtim me vetveten, raportin e vlerësimit dhe duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit ka bërë analizën e çmimeve jo reale. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në raportin e vlerësimit të dt. 17.12.2019 konstaton se gjatë procedurës së përpilimit të këtij raporti tek pika IDENTIFIKIMI I TENDERUESEVE TË REKOMANDUAR PËR DHENJE TË KONTRATES figuron emri i OE ankues, ndërsa në fund të këtij raporti cekën arsyet e eliminimit po ashtu siç janë vendosur edhe në letrat standarde, po ashtu në këtë raport thuhet se: Komisioni i vlerësimit konstaton se nuk ka oferta të përgjegjshme dhe rekomandon anulimin e tenderit. Prandaj eksperti shqyrtues vjen në përfundim se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Në lidhje me arsyen se OE nuk e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim përmes platformës së e-prokurimit, në lidhje me këtë OE në afatin ligjor e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se për shkak të mos funksionimit, ngarkesës së platformës së e-prokurimit, OE kërkesën për rishqyrtim e ka dërguar përmes protokollit të AK dhe në emalin zyrtar të prokurimit të AK-së dhe tek personi kontraktues i dosjes së tenderit veranda. Sikiraka @ rks-gov.net.

Eksperti shqyrtues sa i përket dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim sqaron se OE është dashur që kërkesës për rishqyrtim ta dorëzojë përmes sistemit e-prokurimit, EDHE PSE OE nuk e ka por me qenë se OE i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi e-mailin në të cilin thuhet se sistemi i e-prokurimit nuk po funksionon as dhe e as sot kërkesën për rishqyrtim ua dërgova në e-mailin e juaj dhe fizikisht. AK ka pranuar dhe ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim. Prandaj nga sqarimet që u dhanë më lart del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 04.02.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 01.02.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 06.02.2020, ku ka qenë prezent kryetari i panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së si dhe ekspertja shqyrtuese, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet

nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së ankues znj. Morina deklaroj: Mbetem pran ankesës se parashtruar , OSHP-se kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues KK-Prishtine si dhe përgjigjeve në lidhje me mendimin e Eksperti Shqyrtues.

Sa i përket përgjigjeve në piken e parë Eksperti Shqyrtues ka cekur se Te gjithë Avokatet duhet ti kenë Licencat, nuk jam pajtuar në lidhje me këtë për arsye se Autoriteti Kontraktues si kriter ka përcaktuar se duhet të jete Avokat me Licence si dhe me Certificate të Biznesit dhe ka kërkuar staf profesional 3 Jurist me provim të jurisprudencës çka do të thotë se unë si OE kam zbatuar këtë kriter me Avokate dhe me 3 Juristë me provim të jurisprudencës ku njeri nga ta është edhe Avokat.

Sa i përket pikës së dytë, jam pajtuar plotësisht me mendimin e Eksperti Shqyrtues në lidhje me çmimet ku tarifat e Odes së Avokateve sipas nenit 4 parashihet se Avokati dhe klienti ose personi i autorizohet mund të kontraktojnë shpërblimet për shërbimet e Avokatit me marrëveshje të lire ndërmjet tyre. Vlen të ceket se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar si kriter që të jenë tarifat ose rregulloren e tarifave të Odes së Avokateve.

Në piken e tretë pajtohem plotësisht me mendimin e Eksperti Shqyrtues

Sa i përket pikës së katërt jam pajtuar pjesërisht pasi eksperti shqyrtues nuk i ka analizuar provat veç e veç dhe nuk i ka ndërlidh njëra me tjetrën dhe konsideroj se AK në raportin e vlerësimit të datë 17.12.2019 gjatë procedurës së këtij raporti tek pika të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës figuron emri i OE ankuesi Fitues ndërsa në fund të këtij raporti ceken pretendimet e pa bazuara të Autoritetit Kontraktues për eliminimin që ndërlidhen dhe konstatimin e Eksperti Shqyrtues sipas pikës 2 të shqyrtimit të ekspertit shqyrtues.

Sa i përket pikës së pestë pajtohem pjesërisht nga se OE ka qenë i vetëdijshëm që gjithë procedura e tenderit duhet të zhvillohet përmes platformës elektronike mirëpo E-prokurimi nuk ka punuar (nuk ka funksionuar) atë ditë prandaj kërkesa për rishqyrtim dhe gjithë dokumentacioni është dërguar përmes e-mailit, njëherit edhe fizikisht kam dorëzuar tek Autoriteti Kontraktues dhe kam njoftuar zyrtarin e Autoritetit Kontraktues që nuk funksionon ku njëherit për këtë kam edhe dëshmi se kam njoftuar edhe përmes e-mailit të gjitha parashtresat janë të dorëzuara tek OSHP.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraça deklaroj: Autoriteti Kontraktues pajtohet me rekomandimin e Eksperti Shqyrtues por kemi disa kundërshtime në përmbajtje të ekspertizës, për deri sa OE

është pjese e Shoqatës së Avokateve të Kosovës konsiderojmë se duhet të përmbahet tarifave të asaj shoqate. Pretendimi i Eksperti Shqyrtues që marrëveshja për çmim është një marrëveshje e lire mes 2 palëve konsiderojmë se mund të behet në mes të personave fizik dhe juridik, por nëse Autoriteti Kontraktues autorizon një person për përfaqësim kërkon respektimin e ligjeve përkatëse është interes edhe mbrojtja e parësë publike. Ka qenë përfaqësimi për kontestin në vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël deri në 10.000 euro çmimi bazë sipas rregullores është 104 euro ndërsa OE ankues ka dhënë çmim 600 euro. Pastaj tarifa për kontest të vogël sipas rregullores është 78 euro ndërsa çmimi i ofruar nga OE është 600 euro. Komisioni konstaton që nuk është në interes të Autoritetit Kontraktues të keqpërdoret paraja publike.

Për stafin profesional komisioni nuk i ka konsideruar të pranueshëm stafin të cilët nuk kanë licencë pune për ushtrimin e profesionit të avokatit ku e dimë për shërbime të veçanta si ajo e Avokaturës kërkohet licencë për ofrimin e atij shërbimi.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Zejnullahu deklaroj: Unë i kam rekomanduar panelit shqyrtues përmes ekspertizës që të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e AP-së. Arsyeja ka qenë për shkak se Autoriteti Kontraktues nuk i ka paraparë qartë kërkesat e tij në këtë rast për shërbime konsulence. Kërkesat e përshtatshmërisë ka cek në bazë të ligjit nën 2 zyrë të avokatit avokate mund të ushtrojnë avokatin në zyrën individuale në zyrën e përbashkët ose në shoqëritë e avokateve të regjistruar në Oden e Avokateve, OE duhet të ofroj dëshmi se është i regjistruar në Ode, në rastin konkret OE ankues është i regjistruar si individualisht mirëpo kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë stafi profesional se paku 3 jurist me provim të jurisprudencës dhe të dëshmohet me certifikate të jurisprudencës, kështu që unë kam lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues duke u konsultuar me disa Avokat të cilët me kanë thënë se nuk mund të përfaqësojnë AK. Ju kam dorëzuar një shkresë Odes së Avokateve për këtë dhe nuk kam marrë ende përgjigje sot më thanë se do të më kthejnë përgjigje se a lejohet këta Jurist të përfaqësojë AK apo Av. Ardita Morina duhet të përfaqësojë Autoritetin Kontraktues në çdo seancë.

Sa i përket çmimeve nuk ka qenë kërkesë e Autoritetit Kontraktues në fillim të respektohen tarifat, këtë është dashur që AK të qes kërkesën e qarte, kanë pasur edhe 2 ankesa tjera mirëpo kanë qenë jo në rregull administrativisht.

Në pyetjen e Kryetarit të Panelit drejtuar përfaqësuesit të AK-së: a është hera e parë që keni iniciuar këtë AP?

Përfaqësuesi i AK-së përgjigjet: po është hera e parë që kemi këtë rast me AP.

Në pyetjen e Kryetarit të Panelit drejtuar përfaqësuesit të AK-së: OE te tjerë që janë eliminuar a i kanë çmimet te përafërta me ankuesin?

Përfaqësuesi i AK-së përgjigjet: Disa kanë te njëjte paramasen, 2 OE te tjerë kanë pasur dukshëm çmimet me te ulëta.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Morina deklaroj: Duke u bazuar ne thëniet e cekura kërkoj nga OSHP që te anuloj vendimit te datës 26.12.2019 te Autoriteti Kontraktues dhe vendimi për anulimin e AP me nr. PR 616-19-8564-2-2-1 te datës 18.12.2019 te Autoritetit Kontraktues dhe te aprovoj ankesën e OE Av. Ardite Morine te shpallet fituese te Tenderit shërbime te veçanta kontraktuale për shërbime te veçanta për nevojën e Autoriteti Kontraktues KK-Prishtine.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraça deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te refuzohet ankesa si e pa bazë dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë se autoriteti kontraktues në bazë të nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ka parapatë si kriter që OE duhet të këtë staf profesional, të paktën 3 jurist me provim të jurisprudencës, ku është cekur që të dëshmohej që juristët të kenë diplomë - certifikatën e jurisprudencës (e nuk është kërkuar licenca). Më tej, OE ankues shton se Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit më ka eliminuar si OE që nuk kam dorëzuar licencën e dy avokatëve (kriter që nuk është kërkuar në dosje të tenderit) edhe pse unë në dosjen e tenderit për stafin tim profesional kam dëshmuar me 3 (tre) jurist me diplomë dhe certifikatë të jurisprudencës ashtu siç është kërkuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se kërkesë e AK-së në dosje të tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qenë:

Përshtatshmëria profesionale

- 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;

- 2. 1. në bazë të Ligjit për Avokatinë, neni 2 Zyra e Avokatit Avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë në zyrën individuale, në zyrën e përbashkët të avokatëve ose në shoqërinë të avokatëve, të regjistruar në regjistrin e Odës. OE duhet të ofroj dëshmi se është i regjistruar në regjistrin e Odës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- 1. Kopje te regjistrimit te biznesit se bashku me veprimtaritë e regjistrimit.
- 2. Certifikatën përkatëse.

9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe Professional: 1. Staf i Profesional Te paktën 3 jurist me provim te jurisprudencës	Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Diploma certifikata e jurisprudencës
-----------	--	--

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se gjatë shqyrtimit të ofertës së OE ankues nga ekspertja profesionale e prokurimit, në ofertën në fjalë tek stafi profesional ka të bashkangjitur certifikatat e dy juristëve të cilat dëshmojnë se personat në fjalë kanë përfunduar provimin e jurisprudencës, po ashtu edhe z. Fatmir Gashi ka vërtetim të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike - Departamenti i Administratës gjyqësore ku thuhet se ka dhënë provimin e Judikaturës me dt.25.06.2006.

Me dt.25.11.2019 AK ka ngarkuar në sistemin e e-prokurimit përgjigjen ndaj kërkesës për informacion shtesë të OE ku në pyetjen e parë thuhet: A është e nevojshme që OE të jenë të licencuara nga oda e avokatëve, apo mjafton të jenë të regjistruar si biznes dhe që ushtrojnë veprimtari juridike. Përgjigja nga ana e AK-së ka qenë: Në bazë të Ligjit për Avokatinë, është obligim ligjor që të jenë të regjistruar edhe në Odën e Avokatëve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se në bazë të nenit 2 të ligjit Nr. 04/L-193 Për Avokatinë potencohet se avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë në zyrën individuale, në zyrën e përbashkët të avokatëve ose në shoqërinë të avokatëve, të regjistruar në regjistrin e Odës. Gjithashtu, OE ankues është dashur të këtë parasysh ligjin Nr. 04/L-193 Për Avokatinë ku sqarohet qartë se duhet të jenë të regjistruar në odën e avokatëve për të ushtruar avokatinë, ku nga ky institucion duhet të pajisen me licencë për të punuar si avokat. OE ankues e ka plotësuar këtë kërkesë te AK-se, **Prandaj, bazuar në sqarimet më lart, ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë se përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar me pretendimet që çmimi i ofertuar nga Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë tejkalon çmimin e tregut i cili është i përcaktuar në bazë të rregullorës për tarifat e avokatëve të datës 18.03.2017. Më tej, OE ankues shton se Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në nenin 30.1 të dosjes së tenderit më ka eliminuar me pretendimet se

çmimi i ofertuar nga OE tejkalon çmimin e tregut në bazë të rregullores së tarifave të Odës së avokatëve, gjë që në dosjen e tenderit kriter për dhënien e tenderit kanë qenë që OE të jetë i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, e nuk ka qenë kriter që çmimet të jenë sipas rregullores së tarifave të Odës së Avokatëve. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në bazë të Neni 4 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, Avokati dhe Klienti ose personi i autorizuar mund të kontraktojnë shpërblimin për shërbimet e Avokatit dhe shpenzimet shoqëruese me marrëveshje të lirë ndërmjet tyre. Gjithashtu, nuk ka qenë kërkesë e AK që të respektohen tarifat e avokatëve. Andaj, **ky pretendim ankimor nuk është i bazuar** sepse ky nen përcakton se Avokati dhe Klienti mund të kontraktojnë shpërblimin për shërbimet e Avokatit dhe shpenzimet shoqëruese me marrëveshje të lirë e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me marrëveshje të lirë në mes të Avokatit dhe Klientit pasi që AK konsideron çmimet mbi çmimet e tregut.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë se AK nuk e ka specifikuar në dosjen e tenderit se çmimet duhet të jenë sipas rregullores së Avokatëve të Kosovës dhe nuk e ka specifikuar se sa palë janë përfshirë në një kontest civil. Të njëjtën gjë nuk e ka sqaruar edhe pas parashtrimit të pyetjeve nga OE për sqarimin e tenderit se sa është numri orientues i porosive që do të bëhet nga AK dhe si do të përcaktohen çmimet për porosi të njëjtit. Përgjigjja nga ana e AK-së ishte se numri i porosive nuk mund të përcaktohet sepse nuk është e mundur ta dimë se sa paditës potencial mund të kemi ose sa seanca do të mbahen. Paneli Shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se AK nuk mund të dijë se sa paditës potencial mund të ketë ose sa seanca do të mbahen. **Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.**

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë me pretendimin se sipas raportit të vlerësimit të dt. 17.12.2019, tek lista e plotë standarde për përshtatshmërinë administrative të tenderit, Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë shihet që i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara (ndërsa OE të tjerë nuk i kanë plotësuar) dhe se komisioni për vlerësimin ka identifikuar tenderuesin Avokat “Ardita Morina”- Prishtinë si të suksesshëm dhe ka rekomanduar për dhënien e kontratës (provë të bashkangjitur e keni raportin e vlerësimit të dt.17.12.2019). Më tej, OE ankues shton se Autoriteti Kontraktues duke qenë në kundërshtim me vetveten, raportin e vlerësimit dhe duke shkelur dispozitat dhe kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit ka bërë analizën e çmimeve jo reale. Paneli Shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se duke u bazuar në raportin e vlerësimit të dt. 17.12.2019 konstaton se gjatë procedurës së përpilimit të këtij raporti tek pika Identifikimi i Tenderueseve të Rekomanduar për Dhënie të Kontratës figuron emri i OE ankues, ndërsa në fund të këtij raporti ceken arsyet e eliminimit po ashtu siç janë vendosur edhe në letrat standarde. Po ashtu, në këtë raport thuhet se: Komisioni i vlerësimit konstaton se nuk ka oferta të përgjegjshme dhe rekomandon anulimin e tenderit. Paneli shqyrtues konsideron se vendosja e emrit të OE ankues tek pika Identifikimi i Tenderuese është gabim teknik me faktin se në fund të raportit ceken arsyet e

eliminimit të OE ankues dhe rekomandon AK që në të ardhmen të jetë me kujdes të gjatë hartimit të raportit të vlerësimit, andaj **ky pretendim ankimor është i pa bazuar.**

Në lidhje me arsyen se OE nuk e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim përmes platformës së e-prokurimit, OE në afatin ligjor e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se për shkak të mos funksionimit, ngarkesës së platformës së e-prokurimit, OE kërkesën për rishqyrtim e ka dërguar përmes protokollit të AK dhe në emailin zyrtar të prokurimit të AK-së dhe tek personi kontraktues i dosjes së tenderit verona.sikiraqa@rks-gov.net. Paneli Shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se OE është dashur që kërkesës për rishqyrtim ta dorëzojë përmes sistemit e-prokurimit, edhe pse OE nuk e ka dorëzuar por me qenë se OE i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi e-mailin në të cilin thuhet se sistemi i e-prokurimit nuk po funksionon as dje e as sot, kërkesën për rishqyrtim ua dërgova në e-mailin e juaj dhe fizikisht. AK ka pranuar dhe ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim. **Andaj, ky pretendim është pjesërisht i bazuar.**

Paneli shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si më lartë dhe në bazë të ekspertës profesionale të prokurimit vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit prokurimit në fjalë është bërë në harmoni me nenin 62 të LPP-së për faktin se oferta e operatorit ekonomik ankues nuk ka plotësuar kërkesën e autoriteti kontraktues. Andaj, autoritetet kontraktues do të konsiderojë ofertën e një OE si të përgjegjshme vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE - Avokat "Ardita Morina"- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.